



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:079532

Datë: 12.11.2021

Numri i dokumentit: 02390618

C.nr.555/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Afijete Sada - Gllgjani dhe zyrtaren ligjore Albana Curri, në çështjen juridike të paditëses B. K. – Q. nga Gjakova, të cilën e përfaqëson i autorizuari Ilir Rogova avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzimeve të transportit, vlera kontestit 1,080.20 euro, pas përfundimit të shqyrtimit përgatitor – publik të mbajtur me 01 nëntor 2021, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të paditurës, me 12 nëntor 2021, murr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT aprovohet kërkesëpadia e paditëses B. K. – Q. nga Gjakova ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për praninë në punë për periudhën kohore nga 05 nëntor 2018 e deri me 15 mars 2021, për gjithsejtë 445 ditë pune, t'ia paguajë shumën në lartësi prej 890.00 euro (tetëqind e nëntëdhjetë euro) pra nga (2 euro për secilën ditë pune), si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të transportit në lartësi prej 70% të biletës së udhëtimit, t'ia kompensojë shumën prej 190.20 euro (njëqind e nëntëdhjetë euro e njëzetë cent) për gjithsejtë 156 ditë të pranisë në punë që nga 05 nëntor 2018 e deri me 11 mars 2021, përkatësisht shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,080.20 euro (një mijë e tetëdhjetë euro e njëzetë cent) në emër të dy kërkesave, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8% në nivel vjetor e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi 01 nëntor 2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale, në lartësi prej 269.00 euro (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro) të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadiës të paditëses B. K. – Q. nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të kompensimit të ushqimit për praninë në punë për periudhën kohore nga 05 nëntor 2018 e deri me 15 mars 2021, përkatësisht për 1 ditë pune, t'ia paguajë edhe shumën tjetër në lartësi prej 2,00 euro, (dy euro) si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të transportit në lartësi prej 70% të biletës së udhëtimit, t'ia kompensojë edhe shumën tjetër prej 41,80 euro (dyzetë e një euro e tetëdhjetë cent) për gjithsejtë 56 ditë të pranisë në punë që nga 05 nëntor 2018 e deri me 11 mars 2021, përkatësisht shumën e përgjithshme në lartësi prej 43,80 euro (dyzetë e tre euro e tetëdhjetë cent) në emër të dy kërkesave, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8% në nivel vjetor e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi 01 nëntor 2021, e deri në pagesën definitive, REFUZHET si e pathemeltë.

## A r s y e t i m

Paditësja në padinë e parashtruar dhe përmes të autorizuarit tw saj, ka parashtruar se është e punësuar tek e paditura. Në momentin kur ushtrohet kjo padi, e njëjta është e sistemuar në shkollat “Kadri Kusari” si dhe “Zekeria Rexha”. Më parë e njëjta ka punuar edhe në fshatin Bishtazhin, në të dy shkollat e këtij fshati dhe atë në paralelen e ndarë të Gjinnazit “Hajdar Dushi” si dhe në shkollën “Gjergj Fishta”. Ka theksuar se duke u bazuar në nenin 255 të Ligjit të Procedurës Kontesimore, ka ushtruar dy kërkesa (kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzime të transportit) e që kërkesat e këtilla gjejnë mbështetje në Kontratën Kolektive Sektoriale të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me SBASHK, datë 18 prill 2017, përkatësisht nenit 35. Në bazë të kalendarëve zyrtarë të viteve shkollore, të lëshuara nga MASHT për afatin e kërkesës së paditëses në raport me shpenzimet e ushqimit, rezulton se e njëjta ka punuar 446 ditë pune në shkolla të ndryshme dhe nuk ka pasur asnjë ditë pushimi. Në raport me kërkesën e dytë të paditëses e cila i referohet shpenzimeve të udhëtimit, në bazë të kalendarëve zyrtarë nga MASHT, paditësja ka udhëtuar 212 ditë pune. Paditësja përpos kompensimit të borxhit (kryegjësë), kërkon edhe kamatën ligjore prej 8 % në nivel vjetor sipas nenit 382 të LMD-së, e cila kamatë fillon të rrjedhë që nga momenti i ushtrimit të kësaj padie, ndërsa në kuptim të nenit 305 të LMD-së, këtu e paditura ka rënë në vonesë me mos përmbushjen e detyrimit. I autorizuari i paditëses përgjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar baza dhe lartësia ashtu që gjykatës i propozoi që të njëjtën ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore në shumë prej .00€, përpilimi i padisë në shumë prej 104.00€ dhe përfaqësimi në seancë në shumë prej 135.00€ përkatësisht në shumë të tërësishme prej 269.00€.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 07 maj 2021 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 17 maj 2021 (siç vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo nuk ka parashtruar fare përgjigjen në padi, përkundër obligimit ligjor.

Shqyrtimin përgatitor të treguar me datë 01 nëntor 2021 Gjykata e ka mbajtur me në mungesë të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt propozimin e të autorizuarit të paditëses dhe në kuptim të nenit 409 paragrafi 2 të LPK-së.

Gjykata gjatë shqyrtimit përgatitor ka bërë administrimin e provave si në vijim: kontratat e punës datë 5 nëntor 2018, Leg.nr.915/21, datë 05 mars 2021, kontrata e punës 02 shtator 2019, Leg. nr. 908/2021, datë 05 mars 2021, kontrata e punës leg nr. 4366/21, datë 04 tetor 2021, vërtetimin me nr. të prot. 505/2021, datë 04 mars 2021, vërtetimin me nr. prot.1696/21, datë 15 mars 2021, vërtetimin me nr. prot. 93/01, datë 08 mars 2021, vërtetimin nr. prot.1360/2020, datë 04 mars 2021, certifikatën e vendbanimit me nr. serik B10310429, datë 5 mars 2021, çmimoren e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve, datë 12 nëntor 2019, ku pas vlerësimit veç e veç të secilës provë dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e paditëses, është pjesërisht e bazuar dhe si e tillë pjesërisht u aprova.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga kontratat e punës datë 06 nëntor 2018, Leg.nr.905/21, datë 05 mars 2021, provohet fakti se këtu paditësja B. K. – Q. ka lidhur kontratë me të paditurën – Gjinnazi “Hajdar Dushi” në Gjakovë – paralelja në Bishtazhin, me datë 05.11.2018 vendi i punës: profesor i gjuhës shqipe

(kohëzgjatje e kontratës – deri në kthimin e arsimtares nga pushimi i lehonisë). Nga kontrata e punës datë shtator 2019 Leg. nr. 908/2021, datë 05 mars 2021, provohet fakti se këtu paditësja ka lidhur kontratë me të paditurën – Shkolla “Kadri Kusari” në Gjakovë dhe Shkolla fillore “At Gjergj Fishta” me datë 02 shtator 2019, vendi i punës: profesor i gjuhës shqipe, me kohëzgjatje të kontratës 02 shtator 2019 – 31 gusht 2020. Nga kontrata e punës Leg nr. 4366/21, datë 4 tetor 2021 provohet fakti se këtu paditësja ka lidhur kontratë me të paditurën – Shkolla “Kadri Kusari” në Gjakovë dhe Shkolla “Zekeria Rexha”, me datë 01 tetor 2020 vendi i punës : mësimdhënëse e gjuhës shqipe (kohëzgjatje e kontratës 01 tetor 2020, deri në kthimin nga pushimi mjekësor i mësimdhënëses Shkëndije Morina). Nga vërtetimi me nr. të prot. 505/2021, i lëshuar nga Gjimmnazi “Hajdar Dushi” në fshatin Bishtazhin, Komuna Gjakovë, datë 04 mars 2021, vërtetohet rrethana se paditësja në institucionin e lartcekur nga data 05 nëntor 2018 e deri me datë 01 maj 2019, ka mbajtur 108 ditë pune. Nga vërtetimi me nr. prot.1696/21, i lëshuar nga Shkolla Fillore M.U “At Gjergj Fishta”, datë 15 mars 2021, provohet fakti se këtu paditësja në institucionin e lartcekur nga data 01 tetor 2019 e deri me datë 11 mars 2020, ka mbajtur 12 orë mësimi në javë, ku nga kjo datë paditësja ka punuar në distancë gjer me datë 18 prill 2020 dhe pas kësaj date ka përfunduar mësimin në shkollën tonë, d.m.th. e njëjta ka punuar dy (2) ditë në javë. Nga vërtetimi me nr 08 mars 2021, vërtetohet fakti se paditësja në institucionin e lartcekur ka vijuar 298 ditë pune. Nga vërtetimi ne nr. prot.1360/2020, i lëshuar nga SHFMU “Zekeria Rexha” në Gjakovë, datë 04 mars 2021, vërtetohet fakti se paditësja në institucionin e lartpërmendur ka punuar 40 ditë punë në periudhën 19 shtator 2020 e deri me 01 mars 2021. Nga certifikatë e vendbanimit me nr. serik B10310429, datë 05 mars 2021, vërtetohet rrethana se paditësja B. K. - Q. e lindur me 22 prill 1992 në Prizren, jeton në Gjakovë, adresa: rruga “Fehmi Agani” nr. 17. Nga çmimorja e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve, datë 12 nëntor 2019, është vërtetuar fakti se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Gjakovë – Bishtazhin, në një drejtim kushton 0.50 euro.

Andaj, gjykata në bazë të provave të sipër administruara si dhe duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit datë 18 prill 2017 dhe Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 22 janar 2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’u bërë kompensimin”, vërtetojë se paditëses në fjalë, në raport me kompensimin e shujtës ditore (prej 2€ në ditë), për ditët e pranisë në punë (445 ditë), i takon shuma prej 890.00 euro, për çka e paditura e cila në rastin konkret e posedon legjitimitetin e plotë pasiv, është e detyruar që të ia kompensojë paditëses shumën e lartpërmendur, ndërsa gjykata në raport me shumën tjetër të kërkuar në lartësi prej .,00 euro, nuk gjeti bazë për aprovim, nga fakti se në vërtetimet e lëshuara nga shkollat përkatëse dhe atë vërtetimi me nr. të prot. 505/2021, i lëshuar nga Gjimmnazi “Hajdar Dushi” në fshatin Bishtazhin, Komuna Gjakovë, datë 04 mars 2021, vërteton faktin se paditësja në këtë institucionin ka punuar 108 ditë pune, ndërsa vërtetimi me nr. prot. 93/01, i lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë “Kadri Kusari” në Gjakovë, datë 08 mars 2021, vërteton faktin se paditësja në institucionin e lartcekur ka punuar 298 ditë pune si dhe vërtetimi ne nr. prot.1360/2020, i lëshuar nga SHFMU “Zekeria Rexha” në Gjakovë, ka provuar faktin se e paditësja ka punuar 40 ditë pune, çka rezulton se paditësja ka punuar 445 ditë pune ashtu që të njëjtës për këtë kriter i takon shuma prej 890.00 euro (445x2=890,00), ndërsa shuma e kërkuar në lartësinë prej 2,00 euro nuk ka mbështetje në provat materiale, për çka të njëjtën lartësi e refuzojë si të pa themeltë.

Sa i përket kërkesës së dytë të paditëses në raport me shpenzimet e udhëtimit në relacionin e lartpërmendur, duke u bazuar në vërtetimet e lëshuara nga shkollat ku ka punuar këtu paditësja dhe çmimoren e lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, si dhe duke pasur parasysh edhe dispozitën ligjore të nenit 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, datë 18 prill 2017 dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse – ku punojnë, i paguhet shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”, vërtetohet se paditësja për këtë kriter të kompensimit, i takon shuma prej 190.20 euro, ndërsa gjykata nuk gjeti bazë edhe për aprovimin e shumës tjetër të mbetur për këtë kriter, përkatësisht shumën prej 41.80 euro, nga fakti se vërtetimi me nr. prot.1696/21, i lëshuar nga Shkolla Filllore M.U “At Gjergj Fishta”, datë 15 mars 2021, konstaton se paditësja në institucionin e lartcekur nga data 01 tetor 2019 e deri me datë 11 mars 2020 (në rastin konkret e njëjta ka punuar 6 muaj e 10 ditë), paditësja ka punuar dy (2) ditë në javë, ashtu që marrë parasysh periudhën e lartcekur rezulton se gjatë kësaj periudhe paditësja ka udhëtuar 48 ditë pune, si dhe vërtetimi tjetër i lëshuar nga Gjimnazi “Hajdar Dushi” në fshatin Bishtazhin, Komuna Gjakovë, datë 04 mars 2021, vërteton faktin se paditësja në këtë institucionin ka punuar 108 ditë pune, përkatësisht e njëjta ka punuar 156 ditë pune dhe duke iu referuar 70% të biletës së udhëtimit (156 ditë pune x 0,70 euro = 190,20 euro) ashtu që paditësja për këtë kriter të kompensimit, i takon shuma prej 190.20 euro, ndërsa shuma tjetër e kërkuar mbi këtë lartësi (përkatësisht shumë prej 41.80 euro) nuk ka mbështetje në provat materiale, për çka të njëjtën e refuzojë si të pa themeltë.

Gjykata vlerëson se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19 qershor 2012 (i cili është në implementim nga data 20 dhjetor 2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditori, përkatësisht këtu paditësja në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet e shujtës ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit në punë, që ka pasur ndaj këtu paditësjes, gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, të njëjtës i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditësja iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 30.00 euro, për përpilimin e padisë shume prej 104.00 euro, dhe për pjesëmarrje në

shqyrtimin përgatitor shuma prej 135.00 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme prej 269.00 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
C.nr.555/2021, me 12 nëntor 2021

GJYQTARJA,  
Afijete Sada - Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK; Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.